



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LUSHNJE**

**RREGULLORE E KUSHTEVE TË TREGTIMIT NË MARKAT**

Me qëllim mirëfunksionimin dhe miradministrimin e aktiviteteve që do të zhvillohen në Markatën e qytetit në lagjen Xhevdet Nepravishta bazuar në ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligj nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligj nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 germa “a” dhe “b”, neni 28 pika 2 ,neni 54 germa “f” dhe “k”: , Vendimi i Këshillit të Bashkisë Lushnje “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2023” hartohet kjo rregullore.

**Neni 1**

**Qëllimi i Rregullores**

Kjo Rregullore synon të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin, administrimin dhe funksionimin e Markatës, të drejtat dhe detyrimet e palëve, procedurat e komunikimit ndërmjet tyre, mbarëvajtjen dhe disiplinën në marrëdhëniet dypalëshe, penalitetet në rast mosrespektimi të kësaj rregulloreje.

**Neni 2**

**Objekti i Rregullores**

Objekt i kësaj Rregulloreje është:

- a) Organizimi, administrimi, dhe funksionimi i veprimtarisë tregtare që do të ushtrohet në Markat duke filluar nga përzgjedhja e tregtarëve që do të ushtrojnë aktivitetin deri në funksionimin e përditshëm të markatës.
- b) Marrëdhëniet midis personave të interesuar për të ushtruar aktivitetet në këtë objekt (tregtarët) dhe Bashkisë Lushnje.
- c) Përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve;
- d) Penalitetet në rast mosrespektimi të dispozitave të kësaj rregulloreje.

**Neni 3**

**Funksionet e administratës**



Bashkia Lushnje dhe konkretisht Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Sektori i Kontrollit dhe Zbatimit, Njësia Administrative Nr. 2 dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike kryejnë të gjitha shërbimet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj në drejtimin operativ, organizativ dhe financiar.

Shërbimet e nevojshme sipas kësaj Rregulloreje janë tërësia e masave organizative, financiare, administrative, në marrëdhëniet dypalëshe, penaltitetet sipas përcaktimeve të bëra në ligj dhe në këtë Rregullore.

Administrata, në përmbushje të funksioneve dhe detyrave të saj dhe personat përgjegjës, garantojnë përmbushjen e detyrimeve, shmangien e konfliktit të interesit, trajtimin e drejtë dhe të barabartë të subjekteve, mbikëqyrin tregun dhe respektimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve përcaktuar në këtë rregullore.

#### **Neni 4**

#### **Dokumentacioni që subjektet duhet të paraqesin me qëllim për të ushtruar aktivitetin tregtar brenda ambienteve të Markatës.**

1. Kërkesë – aplikimi;
2. Dokument identifikues (kartë identiteti ose pasaportë);
3. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore.

#### **Neni 5**

#### **Menyra e Perzgjedhjes**

Përzgjedhja e tregtarëve që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në Markat do të kryhet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në 2 faza:

**Faza I :** Tregtarët që kanë ushtruar aktivitetin e tyre për tregtimin e fruta-perimeve në ish Tregu i Fruta Perime (pranë aneksit të stadiumit), do të kenë mundësinë të bëhen pjesë e kësaj Markate, me anë të një procesi transparent do të përzgjidhen dhe përcaktohen me short vëndet specifike të këtyre tregtarëve.

**Faza II :** Në përfundim të fazës së parë për vëndet e mbetura të lira brenda markatës do ti jipet mundësia tregtarëve të tjere që kanë aplikuar për të ushtruar aktivitetin e tyre në markatë konformë rregullave të përcaktuara qartë në këtë rregullore. Përzgjedhja e tyre do të bëhet me short në një proces transparent dhe të barabartë.

#### **Neni 6**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Lushnje**

1. Përcakton dokumentacionin që duhet të paraqesë subjekti tregtar me qëllim përfitimin e së drejtës për të ushtruar aktivitet tregtar brenda ambienteve të markatës.





2. Administron, verifikon kushtet dhe kriteret e subjekteve tregtare që paraqesin kërkesa dhe dokumentacionin për të ushtruar aktivitetin, në ambientet e Markatës dhe në rast përmbushje të kriterëve lidhen Akt- Marrëveshje midis tregtarëve dhe Bashkisë Lushnje.
3. Mbikëqyr zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje, nga tregtarët që ushtrojnë aktivitetin e tyre brënda ambjenteve të Markatës dhe evidenton konstatimet e bëra me procesverbal.
4. Komunikon me subjektet tregtare në formë shkresore duke i vënë në dispozicion konstatimet e bëra.
5. Në rast mos përmbushje të detyrimeve nga subjektet tregtare, Bashkia Lushnje ka të drejtë të njoftojë, paralajmërojë subjektet tregtare vetëm njëherë. Nëse subjekti tregtar nuk përmbush detyrimet dhe pas lajmërimit të bërë, Bashkia Lushnje të prishi Akt - Marrëveshjen e lidhur midis palëve dhe largimin e subjektit tregtar nga Markata.
6. Bashkia Lushnje pas përfundimit të përzgjedhjes së tregtarëve dhe hapjes së markatës harton një listë pritje, ku renditja e subjekteve tregtare që kërkojnë të zhvillojnë aktivitetin e tyre në Markat, vlerësohet sipas datës më të hershme të kërkesës të subjektit tregtar protokolluar në Bashkinë Lushnje, dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti.

#### **Neni 7**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve tregtarë**

1. Subjektet tregtare duhet të bashkëpunojnë në funksionimin e tregjeve.
2. Subjektet tregtare duhet të jenë në përputhje me të gjitha, rregullat dhe rregulloret që janë në fuqi, ose që do të miratohen në vijim, që rregullojnë veprimtarinë lidhur me shitjen, ruajtjen ose trajtimin e ushqimit ose produkteve të tjera.
3. Subjektet tregtare do ta mbajnë zonën një vend të pastër, të sigurt, sipas rregullave higjeno- sanitare gjatë gjithë kohës.
4. Subjektet tregtare duhet të heqin mbeturinat dhe ti derdhin ato menjëherë në vendin e përcaktuar;
5. Pastërtia personale e personelit të tregut që merret me ushqimin, është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e subjektit tregtar;
6. Subjektet tregtare duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, për të parandaluar kushtet që shkaktojnë ose kontribuojnë në anomali, si aroma, zhurma, thyerje të cilat nuk janë të përshtatshme në treg.
7. Kur objekti banak ose vendi i ushtrimit të aktivitetit, dëmtohet tërësisht ose pjesërisht nga tregtarët, përgjegjësia financiare për të riparuar objektin e dëmtuar është e vetë subjekti tregtar.
8. Subjekti tregtar nuk duhet të shpërndajë ose të vendosë, broshurë reklamash, karta, fletëpalosje, shenja, shfaqje, në ambientet e përbashkëta të Markatës. Vendosja e



broshurave, reklamave për produktet e tregtuara në ambientin ku ushtrohet aktiviteti, bëhet vetëm me pëlqimin e Bashkisë Lushnje.

9. Subjektet tregtare kanë të drejtë dhe detyrim të vendosin shenja të çmimeve, të shkruara në mënyrë të rregullt në çdo produkt që tregtojnë;
10. Te gjitha produktet dhe objektet e tjera duhet te jenë të sistemuara brenda hapësirës së përcaktuar nga Bashkia Lushnje;
11. Subjektet tregtare që do të ushtrojnë aktivitetin, do të shesin vetëm produkte që përfshihen në kategoritë fruta, perime ,bulmetore, erëza të ndryshme, fruta të thata dhe arrorët..
12. Subjektet tregtare nuk mund ta lëshojnë me nën qira hapësirën e tyre.
13. Subjekti tregtar i cili ka paraqitur kërkesë për vend ushtrimi aktiviteti në Markat, ka të drejtë të kalojë në listë pritje, në rastin kur nuk ka ambient të lirë për të dhënë në përdorim.

### **Neni 8**

#### **Etika**

1. Është e ndaluar sjellja e çrregullt dhe gjuha e egër, vulgare ose e turpshme në Markat;
2. Është e ndaluar mbajtja e kafshëve shtëpiake qen, mace, apo çdo kafshe tjetër, në ambientet e markatës;
3. Ndalohet pirja e duhanit brenda hapësirës së mbyllur të Markatës;

### **Neni 9**

#### **Uniforma & Veshja**

Të gjithë tregtarët e markatës duhet të kenë përparësen e tyre te dallueshme nga lloji i produktit qe do të tregtojnë.

### **Neni 10**

#### **Oraret e funksionimit të Markatës së Shijes**

Markata do të jetë e hapur çdo ditë të javës, nga e Hëna në të Diel, gjate gjithë muajve të vitit.

Furnizimi nga subjektet tregtare, me produktet që do të shesin, do të bëhet nga ora 06:00 deri në orën 08:00 . Mbas këtij orari nuk lejohet shërbim i kësaj natyre.

### **Neni 11**

#### **Pagesa e tarifës së përdorimit**





Pagesa do të bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës, pas lëshimit të faturës nga ana e Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

### **Neni 12**

#### **Penalitetet**

Në rast mospagimi në kohë të detyrimeve, subjektet tregtare duhet të paguajë një gjobë për vonesë në pagesë 0,06% të shumës, për çdo ditë që pagesa nuk është kryer.

Në rast të mospagimi të tarifës për dy muaj të njëpasnjëshëm, subjektit tregtar i revokohet kontrata nga bashkia Lushnje duhet të lirojë vëndin e ushtrimit të aktivitetit..

Kontrata revokohet në rast se subjekti tregtar nuk respekton të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kjo rregullore, nuk respekton deklaratën individuale, kërkesë – aplikimin.

### **Neni 13**

#### **Dispozitat e fundit**

Të gjithë subjektet tregtare, që ushtrojnë aktivitet në Markat, duhet të njihen individualisht me këtë rregullore dhe nëse e shohin të nevojshme, të kërkojnë sqarime dhe interpretime për këtë të fundit, pranë Sektorit të Kontrollit dhe Zbatimit në Bashkinë Lushnje;

Kriteret dhe përmbajtja e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë subjekteve që i kundër drejtohet;

Kryetari i Bashkisë Lushnje nxjerr urdhra dhe vendime për zbatimin e kësaj rregulloreje;

Çdo subjekt tregtar që ushtron aktivitet në Markat, të pajiset me një kopje të Rregullores së Brendshme. Gjithashtu kopje të kësaj rregulloreje të afishohen në ambientet e përbashkëta të Markatës në vende të dukshme.

Mosnjohja e rregullores, nuk e justifikon subjektin tregtar nga përgjegjësia dhe penalitetet e lartpërmendura.

Dispozitat e kësaj rregulloreje do të ndryshohen, zëvendësohen, shtohen dhe shfuqizohen me vendim të Këshillit të Bashkisë Lushnje, sipas legjislacionit në fuqi

### **Neni 14**

#### **Strukturat përgjegjëse**

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e kësaj urdhërese janë:

- a. Kryetari i Bashkisë së Lushnjës – organ autorizues/lejujes;
- b. Policia Bashkiake – organ inspektues për zënien e hapësirës publike në bazë të Ligjit Nr. 8224, datë 15.05.1997, për “Organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe



- komunës” (i ndryshuar);
- c. Drejtoria e Shërbimeve – organ inspektues për dëmtimin e ambienteve të markatës.
  - d. Drejtoria e të Ardhurave Vendore e Bashkisë Lushnje - organ për arkëtimin e tarifës për zënie e hapësirës publike dhe tarifës së pastrimit në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 117 datë 21.12.2022 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Lushnjes ”dhe ndryshimeve që mund të pasoj në vijim.
  - e. Ndërmarrja e Pasurisë Publike – organ që do të kryej të gjitha shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe riparimin e objektit, vendeve të tregtimit etj.